



**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE I KOSOVËS
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr. 4, datë 22.11. 2023

PËR

**PROPOZIMIN E TEKSTIT MËSIMOR ME TITULL “GJUHA SHQIPE DHE
KULTURA SHQIPTARE”, NIVELI II, SI TEKST FITUES TË KONKURSIT PËR
TEKSTIN MËSIMOR PËR MËSIMIN PLOTËSUES NË DIASPORË DHE NË
MËRGATË**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën (në vijim Komisioni i Përbashkët), i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.09.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, Vendimin nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Urdhrin nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën” dhe Urdhrin/Vendimin e Përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, “Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.

V E N D O S :

T'i propozojë ministrave përgjegjës për arsimin të të dy vendeve tekstin mësimor me titull "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare", niveli II, të përgatitur nga shtëpia botuese "Albas" në partneritet me shtëpinë botuese "Dukagjini", si tekst fitues të konkursit për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë, niveli II.

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Znj. Anila Ferizaj

Z. Arbër Salihi

Znj. Feime Llapashtica Lipsomb

Znj. Erida Koleci

Znj. Ardjana Gjini

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Isni Kryeziu

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

Znj. Evis Mastori